

TAKIMI I PARË 2023 - KOMITETI SEKTORIAL I MIKPRITJES DHE TURIZMIT

Takimi i parë i Komitetit Sektorial të Mikpritjes dhe Turizmit u zhvillua më datë **04.05.2023**.

Mbledhja u hap me prezantimin e anëtarëve të Komitetit Sektorial, duke përfshirë profesionin, pozicionin e punës dhe eksperiencën e tyre në fushë. Mbledhja u fokusua tek: prezantimi i kuadrit ligjor për Komitetet Sektoriale, prezantimi i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, prezantimi i rregullores për funksionimin e Komiteteve Sektoriale, si dhe zgjedhja e Kryetarit të Komitetit Sektorial.

Gjatë mbledhjes u theksua rëndësia e produkteve të Komitetit Sektorial, pasi turizmi dhe mikpritja ishin ndër prioritetet e zhvillimit ekonomik të vendit. Sekretariati Teknik informoi se, me mbështetjen e partnerëve do të realizohej një studim për të evidentuar nevojat për aftësi të tregut të punës në fushën e mikpritjes dhe turizmit.

Gjatë diskutimit u theksua se, vendimet që do të merreshin nga Komiteti Sektorial, pas analizimit të gjetjeve të Studimit të Nevojave për Aftësi të tregut të punës për kualifikimet profesionale, do të pasqyroheshin në Katalogun Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale. Sekretariati Teknik theksoi rolin e Komitetit Sektorial për përditësimin dhe përmirësimin e ofertës aktuale të kualifikimeve profesionale, si dhe validimin e standardeve të profesioneve dhe standardeve të kualifikimeve profesionale. Në përfundim të takimit u zgjodh Kryetari i Komitetit Sektorial të Mikpritjes dhe Turizmit.